- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare;
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Cdo Operatori Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Njoftimin e Kontratës, Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti/enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti /enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
    - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
    - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të

rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit(Paraprak)

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër(Paraprak)

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

**Shtojca1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventividhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomikee detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
 [ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit /entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Bashkangjitur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TËPUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve:**

**Sipas grafikut bashkangjitur DST**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>Afati i realizimit (7 jave)</i>		
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>			
1.				
2.				
3.				
4				

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit. 16,666,666 (Gjashtembedhjetemilion e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

#### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që

prokurohet Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme

• Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, si dhe fatura tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, e shoqëruar me fatura tatimore , dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e Vkm nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit , klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**1. N.P – 1 A Punime gjurmimi ne toke**

**2. N.P – 4 A Rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvai,metro,pista aeroportuale**

**3. N.S -- 18 A Punime topogjeodezike**

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikoh n të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimi t i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikoh n të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<b>N.P – 4</b>	<b>Rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha, tramvai,metro,pista aeroportuale</b>		A	0 – 20 mln
<b>N.P – 1</b>	<b>Punime gjurmimi ne toke</b>		A	0 – 20 mln
<b>N.S -- 18</b>	<b>Punime topogjeodezike</b>		A	0 – 20 mln

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbulim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje të parrezikshme”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

**2.3.4** Një punësim mesatar i të paktën 15 (Pesëmbëdhjete) personave, të cilët duhet të jenë pjesë e listës së pagesave minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me :

a. Vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar .

b. Listës së pagesave të punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklaramit.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**2.3.5** Operatori/et ekonomike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të vërtetojë se ka **ne licensën e shoqërisë si** drejtues teknik për kryerjen e punimeve në këto objekt,

Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Inxhinier Gjeodet/topograf 1 (nje)

**Për stafin e mësipërm të paraqiten:**

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata,

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punëtorinë dhe stafin teknikë që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklaramit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklaramit në formularin përmbledhës të vetëdeklaramit për pikat a, b, d, dh, e, h, l, j të pikes 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaramit Drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të figurojë në listës së pagesave minimumi 3



muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjse se ofertave shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- Kontratë individuale të punës te vlefshme
- Diploma perkatese

*Ne rastin e Bashkimit te op.ekonomik secili op.ekonomik te percaktoje me ane t enje deklarate Drejtues teknik te punimeve ne objekt.*

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe perpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, l, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.**

*2.3.7Op.ekonomik duhet te kete te punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve vërtetuar me kontrata te vlefshme pune,diplome te leshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore,deshmi kualifikimi te sigurimit teknik leshuar nga ISHT apo nga subjekte juridike private te akredituara per certifikimin e punonjësve si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise minimumi ne periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.*

- 3 punonjes manovrator
- 1 punonjes teknik ndertimi
- 4 punonjes automakiniste

#### **Për stafin e mësipërm të paraqiten:**

- Kontratë individuale të punës te vlefshme
- Diplomen qe te vertetoj kualifikimin profesionale te mesiperm
- Certificate e sigurimit teknik e vlefshme
- Leje drejtimi (certificate e aftesise profesionale,patente manovrimi nga DPSHTRR (vetem per punonjesit manovrator/shofer)

Ne rastin kur punonjesit manovrator jane te kontraktuar me kontrate pune (respektivisht per mjetet e marra me qera ) nuk kerkohe te figuroje ne listpagesat e shoqerise.

*Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,deklarata B ,op.ekonomike duhet te deklarojne per punojsit e mesiperm,profilin e punes,numrin e kontrates individuale te punes.*

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe perpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, l, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.**

**2.3.8**Operatori ekonomik duhet te kene ne stafin e tyre personel te kualifikuar/certifikuar si :

a) 1 (nje) punonjes i paisur me certificate “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” ne perputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 ,date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe VKM nr.312 date 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores per sigurine ne

kantier” shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, Diplome/Çertifikate si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise minimum per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.(Ne rast bashkimi op.ekonomik secili op.ekonomik duhet te kete pjese te stafit nje punonjes.

*Shënim:Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.9 Operatori** ekonomik duhet te paraqese me ane te nje deklarate listen e personelit kryesor te nevojshme per te zbatuar objektin dhe nje cv te shoqerise per punet e realizuar gjate aktivitetit te saj.Ky dokument te paraqitet ne sistemin elektronik gjate fazes se ofertimit ne SPE.

**2.3.10 Op.ekonomik** duhet te paraqese grafikun e punimeve te detajuar sipas zerave te preventivit te shprehur ne afatin kohore te percaktuar ne DST (7 jave) kalendarike.Grafiku i punime dhe afati i percaktuar jane pjese e dokumentacionit teknik hartuar dhe kontrulluar nga struktura teknike e posacme (urbanistika).

**2.3.11 Operatori** ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi ne 20 ton	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
2	Kamino vetshkarkues deri 10 - 15 ton	Ne pronesi ose me qira	2 (dy) cope
3	Ekskavator me zinxhirë me krahë të gjatë mbi 18 m	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
4	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
5	Autobot uji	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
6	Asfaltoshtruse	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
7	Grejder	Ne pronesi ose me qira	1 (nje)cope
8	Vibrator thellesie	Ne pronesi ose me qira	1 (nje)cope
9	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
10	Rrul me gome – cilinder mbi 18 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
11	Rrul me cilinder – cilinder deri 8 ton	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
12	Betoniere kantjeri	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
13	Armatura betoni	Ne pronesi ose me qira	30 m2
14	Gjenerator	Ne pronesi ose me qira	1 (nje) cope
15	Karroca dore	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope
16	Lopata	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope
17	Kazma	Ne pronesi ose me qira	5 (pese) cope
<b>PAJISJE MBROJTESE</b>			

Kokore	15 copë
Jeleke	15 copë
Kuti te ndihmës së shpejtë	3 cope
Tabela sinjalistike mbrojtese	10 cope

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

- a) Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- b) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- e) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- f) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur fature zhdoganimi/fature tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri teknologjike dhe mjete dhe paisje të deklaruar.
- h) Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të kete të dallueshme edhe targën e mjetit.
- i) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

- a) Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësive, E akredituar nga DPA ose Organizma Nderkombetar Akreditues të njohur në Republika e Shqipërisë./ **ekuivalente dhe e vlefshme**
  - b) Certifikate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit të ambientit E akredituar nga DPA ose Organizma Nderkombetar Akreditues të njohur në Republika e Shqipërisë / **ekuivalente dhe e vlefshme**
  - c) Certifikate ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) E akredituar nga DPA ose Organizma Nderkombetar Akreditues të njohur në Republika e Shqipërisë / **ekuivalente dhe e vlefshme**
- Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**2.4.2** Op.ekonomik duhet të paraqesë vertetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023. Në rastin e bashkimit të op.ekonomik, çdo antar i grupit duhet të dorëzojë vertetimin e leshuar nga Autoritete përkatëse në të cilin është regjistruar sipas QKB.

*Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.4.3** Op.ekonomik duhet të sjellë vertetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka op,ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

*Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. Op.ekonomik duhet te permbush dhe kushtin per sjelljen e dokumentacioni te percaktuar ne DST per Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:*

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

*Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

#### Sqarim

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 9 të Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit për këtë verifikim.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetdeklarimit.

- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

## Shtojca9

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

### FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti ose Enti kontraktor/Investitori
Adresa/Tel.
Emri i Titullarit/Administratorit
<b>VËRTETOJ SE:</b>
Autoriteti ose enti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me
Emri i operatorit NIPT/
Bashkimit të operatorëve NIPDET/
Nënkontraktoret NIPDET
Adresa/t

Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
